



Datë: 06.11.2025
Numër Protokolli: 7230/2025

A.nr.1092/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1092/2025, të datës 09.06.2025, të parashtruar nga ankuesi S.B, kundër organit të punësimit: Ministria e Ekonomisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 07.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me A.nr.1092/2025, e datës 09.06.2025, e parashtruar nga ankuesi S.B.

II. Mbetet në fuqi Akti-përfundimtar me numra të protokollit 218, i datës 16.05.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë lidhur me rezultatin përfundimtar të kandidateve në procedurën me numër reference RN00017130.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil S.B (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 09.06.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017130, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar për Teknologji të Reja, të shpallur më datë 18.03.2025, nga Ministria e Ekonomisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë, ndërsa, kjo e fundit ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3837/2025, të datës 09.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimi të ankesës të datës 09.06.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 20.06.2025, së bashku me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Konkursin me numër reference RN00017130, të datës 18.03.2025; Lista e kandidatëve në pritje; Lista e aplikantëve (aprovuar dhe refuzuar); Njoftim me numër protokolli Nr.2041, të datës 29.04.2025; Vendim për themelimin e komisionit me numër protokolli Nr.2120, të datës 12.05.2025; Akt emërimit me numër protokolli Nr.2338/2024, të datës 16.09.2024; Vendim me numër protokolli Nr.101, të datës 10.01.2025; Akt emërimi me numër Nr.16/2024, të datës 30.07.2024; Akt emërimi me numër Nr.30/2024, të datës 30.07.2024; Akt emërimi me numër Nr.01/2024, të datës 30.07.2024; Akt emërimi me numër Nr.Ref:DTIK-4/2020, të datës 08.05.2020; Vendim me numër protokolli Nr.3420, i datës 04.04.2024; Përshkrimet e vendeve të punës në Ministrinë e Ekonomisë; Njoftimin për rezultatin përfundimtar, të datës 16.05.2025; Njoftim për kandidatin fitues me numër protokolli Nr.2182, i datës 16.05.2025; Njoftim për rezultatin përfundimtarë me numër protokolli Nr.2181, i datës 16.05.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve, e datës 16.05.2025; Pyetjet për intervistë, të datës 16.05.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatët në intervistë, të datës 16.05.2025; Rezultati i testit me shkrim; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatëve nga komisioni i pranimit, të datës 14.05.2025; Njoftimin e datës 19.06.2025; Njoftimin e datës 29.04.2025; Njoftim për verifikim paraprak, me numër protokolli Nr.2038, i datës 29.04.2025; Aplikacioni me datë aplikimi 07.04.2025, të kandidatit S.H, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 15.04.2025, të kandidatës A.B, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 21.03.2025, të kandidatës E.H, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 15.04.2025, të kandidatit Q.I, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Renditja përfundimtare nga SIMBNJ; Testi me shkrim për kandidaten A.B; Testi me shkrim për kandidatin Q.I; Testi me shkrim për kandidaten E.H; Vendimin e Kryetarit të Këshillit me Nr.prot. 4909/2025, të datës 22.07.2025, emali i datës 06.11.2025 nga NJBNJ të ME-së, Akt emërimi me Nr.110/2025, të datës 27.06.2024, të A.B; Renditjen përfundimtare nga SIMBNJ, të datës 16.05.2025, lidhur me konkursin RN0001730, pozita Zyrtari I Lartë I IT-së për Identifikim Elektronik, Formularin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën Zyrtari I Lartë I IT-së për Identifikim Elektronik; Konfirmimin për përfundimin e konkurrimit të datës 18.03.2025, lidhur me konkursin RN0001730, pozita Zyrtari I Lartë I IT-së për Identifikim Elektronik.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Ekonomisë më datë 18.03.2025, ka shpallë konkursin publik për pranim me numër reference RN00017130, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita e punës *Zyrtar për Teknologjitë e Reja* në Departamentin e Teknologjisë Informative dhe Komunikuese, klasa profesional 2, një (1) vend i lirë pune, i hapur për aplikim nga data 19.03.2025 deri më datë 17.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës del se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, të cilit sipas njoftimit me nr.protokolli 038 të datës 29.04.2025, i është refuzuar aplikacioni më arsyetimin se nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës, pasi që ankuesi nuk ka ofruar dëshmi se ka përvojë të punës profesionale pas diplomimit të arsimit të lartë të nivelit bechelior dhe i mungon pasqyra e pagesave të kontributeve pensionale apo detyrimeve tatimore.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë më datë 16.05.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli Nr.2181 nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë të suksesshme për procedurën përkatëse të rekrutimit janë shpallur: A.B me 84.2 pikë, Q.I më 79 pikë, dhe E.H me 75.4 pikë.

Ankuesi pas publikimit të Njoftimit të rezultatit përfundimtar ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar njoftimin për refuzimin e aplikacionit, mbi pretendimin ankimor se i plotëson të gjitha kriteret e konkursit, dokumentacioni është dorëzuar në mënyrë të rregullt, nën supozimin se në këtë proces ka pasur mungesë të transparencës dhe keqinterpretim të përvojës së kërkuar. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar.

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e rekrutimit RN00017130 dhe si rrjedhojë nuk ka arritur të evidentoj shkelje ligjore esenciale të cilat si të tilla do të cenon ligjshmërinë e procesit të kontestuar. Në kontest të këtij përcaktimi, Kolegji fillimisht ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit ku ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), Arsim i lartë i paspecifikuar. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vite përvojë pune profesionale.**

Në kuptim të bazushmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i`u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Nenit 9 par. 1, 2: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t`i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t`u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj. 2.Përgjashtimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkohen kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.*

-Nenit 39: 1.Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së”,

2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi....”

Po ashtu, Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe nenin 6, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohej se: 2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Bazuar në kuadrin ligjor si më lart, Kolegji ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje administrative ku si rrjedhojë kolegji erdhi në vlerësimin se nuk gjejnë mbështetje pretendimet ankimore lidhur me refuzimin e aplikacionit, mbi arsyet se nga analizimi shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesi më rastin aplikimit (datë 07.04.2025 ora 14:21:27) është vërtetuar se i njëjti ka ofruar si dëshmi Diplomën më nr.1422/19, të datës 18.07.2019, të lëshuar nga Kolegji AAB, për përfundimin e studimeve beachelor më datë 17.07.2019, në programin studimor “Shkenca Kompjuterike”, kurse lidhur me përvojën e punës ankuesi ka ofruar si dëshmi shkresën pa titull dhe datë të lëshimit, më të cilën konfirmohet se ankuesi ka punuar në kompaninë “ Osmani Holding Sh.p.k” në periudhën janar-korrik 2022, si IT Support, Kontratën e Punës më Kompaninë “ Abidat” SHPK, sipas të cilës ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune pa afat të caktuar, më fillim nga data 01.12.2019, mirëpo, përvoja e punës tek kompania “Osmani Holding” nuk shoqërohet me dëshmi nga Trusti Pensional apo nga Administrata Tatimore, kurse, lidhur më përvojën e punës tek kompani “Abidat” ankuesi ka dëshmi nga Trusti Pensional lidhur me periudhën gusht 2018 deri mars 2019, periudhë kjo para diplomimit të ankueist.

Ankuesi si dëshmi tjetër lidhur me përvojën e punës ka ofruar Kontratën e punës nr.protokolli 03-456-2024, të lidhur me Agjencinë për Statistika të Kosovës, për angazhim si Mbikëqyrës në aktivitetin e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, për periudhën kohore 22 mars deri 04 qershor 2024 (2 muaj e 12 ditë), Kontratën e datës 21.10.2024 për punë praktike me Ministrinë e Ekonomisë, për periudhën 01.11.2024 deri 30.04.2025 (5 muaj dhe 7 ditë deri me datën 07.04.2025 si datë e aplikimit) si dhe Marrëveshjen për punë praktike me Kompaninë “Abidat” SHPK, në periudhën 23.07.2018 deri 22.01.2019, por qe kjo praktikë ka të bëjë me periudhën para diplomimit. Andaj, mbi gjendjen e këtyre fakteve, rrjedhë së ankuesi nuk ka arritur të ofroj prova që argumentojnë se i njëjti ka nja vit përvojë pune profesionale ashtu siç ishte kërkuar më konkurs, andaj, edhe mbi këto rrethana Njësia e Personelit të Ministrisë së Ekonomisë, më rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7.1 ku përcaktohet se: *7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.*

Marrë parasysh së procedura e kontestuar ka përfunduar më tre kandidatë të suksesshëm, e duke qenë se sipas njoftimit të datës 06.10.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë kandidatja me më shumë pikë A.Bytyqi është përzgjedhur në këtë institucion në pozitën Zyrtare e lartë e TI-së për Identifikim Elektronik, dhe se e njëjta ka nënshkruar edhe aktin e emërimit më datë 01.07.2025, atëherë, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e kandidatit të dytë të suksesshëm Q.I në kuptim të kriterëve të përgjithshme formale dhe si pasojë ka gjetur se kandidati Q. I posedon Diplomën Nr.1671/23, të datës 05.09.2023, të lëshuar nga Kolegji AAB, për përfundimin e studimeve themelore më datë 05.09.2023, në Programin Pikturë dhe Arte Vizuale, ndërsa, përkitazi me përvojën e punës pas diplomimit kandidati ka bashkangjitur, Kontratën me numër 213-23-11255-2-3-6/C47, të datës 15.11.2023, të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, me të cilën ka qenë i angazhuar si Ekspert për Multimedia dhe Ritenderim II dhe atë nga data 15.11.2023 deri më datën 14.11.2024; si dhe Kontratën me numër 213-24-11133-2-3-6/C68, të datës 15.11.2024, të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, me të cilën ka qenë i angazhuar si Ekspert për Multimedia dhe atë nga data 15.11.2024 deri më datën 15.11.2025; (kandidati posedon edhe përvojë tjetër, por, për kolegjin nuk ishte relevante, pasi që përvoja e lartë cekur përmbushë kriterin e përvojës profesionale pas diplomimit). Pra, mbi bazën këtyre fakteve rezulton së kandidati Q.I ka plotësuar kriteret formale për pozitën përkatëse, ka grumbulluar numrin e nevojshme të pikëve për tu konsideruar kandidat i suksesshëm, ndërsa, nisur nga fakti së kandidatja A. Bytyqi, konsiderohet e tërhequr nga lista përfundimtare, atëherë, kandidati Q.I renditet si kandidati i radhës më më shumë pikë të arritura.

Thënë si më sipër, e meqenëse nuk janë evidentuar shkelje esenciale ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me numër reference RN00017130, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1092/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, S.B;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Ekonomisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.